

Data 30.01.2025  
Ora 16:05

## RENDI I DITËS

Projektvendim “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, i ndryshuar.

### PJESËMARRJA :

#### KQZ:

- Komisioni Rregullator:

- Ilirjana NANO Kryetar
- Arens ÇELA Anëtar
- Dritan ÇAKA Anëtar
- Helga VUKAJ Anëtar
- Muharrem ÇAKAJ Anëtar
- Stafi KQZ Znj. P. Doçaj, z. B. Kodra
- Parti politike: PD (z. F. Nuri)

#### OJQ:

Znj. I. Nano: Përshëndetje! Fillojmë mbledhjen e Komisionit Rregullator të njoftuar për ditën e sotme në orën 16.00. Në mbledhje janë të pranishëm të gjithë anëtarët e Komisionit Rregullator, zyrtarë të administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, përfaqësues të partive politike dhe përfaqësues të shoqërisë civile. Në mbledhjen e ditës së sotme kemi për shqyrtim një projektvendim, “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt. 30.01.2025*

Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, i ndryshuar.

Në respekt të Kodit Zgjedhor, ky projektvendim është propozuar për shqyrtim nga dy anëtarë të Komisionit Rregullator, zonja Vukaj dhe zoti Çakaj. Para se të fillojmë me shqyrtimin e projektvendimit, doja të pyesja së pari anëtarët e Komisionit Rregullator, më tej përfaqësuesit e partive politike nëse ka çështje jashtë rendit të ditës për të mbajtur radhën e folësve. Zoti Çakaj.

**Z. M. Çakaj:** Faleminderit, zonja kryetare! Edhe për procedurë, edhe në lidhje me rendin e ditës, unë kisha diçka që besoj është shumë e rëndë, është ngjarja më e rëndë që ka ndodhur në këta katër vjet në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Praktikisht, sigurisht që do ta sqaroj...

**Znj. I. Nano:** Zoti Çakaj, doni ta diskutoni tani, jo jashtë rendit të ditës? E lidhur me rendin e ditës.

**Z. M. Çakaj:** E lidhur me rendin e ditës dhe tani besoj se tani është momenti i duhur, edhe për procedurë për të sqaruar çfarë ka ndodhur. Praktikisht është tentuar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, zoti Ilirjan Celibashi, dhe administrata e tij të manipulohet, falsifikohet rendi i ditës për mbledhjen e thirrur nga dy anëtarët e Komisionit Rregullator. Po e sqaroj më konkretisht se çfarë ka ndodhur. Siç jeni në dijeni, siç e relatuat edhe ju, në datën 27 janar ju kemi bërë me dije në orën 14.45, ju kemi përcjellë edhe një projektakt bashkë me relacionin përkatës, të nderuar juve, kolegë të Rregullatorit, dhe ia kemi dërguar edhe drejtoreshës juridike të KQZ-së, zonjës Pavlina Doçaj. Nga informacioni që ne

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*

 2

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt. 30.01.2025*

disponojmë, e provuar nga zyra e protokollit të KQZ-së, protokollimi i kërkesës sonë për thirrjen e mbledhjes së Komisionit Rregullator është kryer një orë e gjysmë me vonesë. Pra, për të zbritur nga kati i dytë i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në katin e parë, që është jo më shumë se 30 sekonda, është dashur një orë e gjysmë, sepse, e provuar me imeil të zonjës Xebinaku, që është personi përgjegjës në zyrën e protokollit, rezulton që shkresa jonë është regjistruar në protokoll në orën 16.15 minuta dhe më pas në sistemin supersonik EDMS, çfarë ndodh këtu në KQZ, se i kemi paret për t'i harxhuar në këto histori, është protokolluar në orën 16.35. Pra nga zyra e protokollit shkresor 16:15, është dashur edhe 20 minuta të tjera për t'u protokolluar në sistem EDMS. Ndërkohë, e nderuar, që ne ishim në pritje të thirrjes zyrtare të mbledhjes së Komisionit Rregullator me kërkesë të dy anëtarëve, në orën 16.39 po të datës 27 janar na vjen nga zonja Hoxhaj një imeil ku na është përcjellë për njohje dhe mendim një projektvendim, i cili është propozuar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve dhe me këtë projektvendim mbivendoset propozimi për disa shtesa e ndryshime në vendimin nr. 9. Pra, i njëjti propozim që është bërë tashmë nga ne dy anëtarët e Komisionit Rregullator, për arsye që nuk e di, t'i shpjegojë vetë Komisioneri, dhe mirë do të ishte të ishte këtu e t'i shpjegonte, e ka propozuar edhe ai. Në rastin konkret unë kam një shqetësim, të nderuar kolegë të Rregullatorit: kur tentohet të manipulohet mbledhja e Komisionit Rregullator, po me votën e shqiptarëve çfarë bëhet? Po me regjistrimin e kërkesave nga jashtë çfarë ndodh? Po me administrimin e rezultatit zgjedhor çfarë ndodh? Ky institucion, pra Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, gjithë linja, ka humbur kredibilitetin, ka humbur integritetin me veprimet e tij nga data 27 janar e deri më sot. Sigurisht që ka qenë vendosmëria ime dhe e koleges Vukaj për të mos e lejuar këtë tentativë manipulimi, falsifikimi të ndodhte. Kjo është e provuar. Ne për këtë veprim kaq të rëndë do të informojmë, së pari, Kuvendin, organin e emërtesës së të gjithë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, do të

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt. 30.01.2025*

informojmë organizatat ndërkombëtare dhe organizatën kryesore që monitoron zgjedhjet, që është OSBE-ODIHR-i, sigurisht do t'i përcjellim edhe informacion për ta vlerësuar organeve ligjzbatuese në vend. Kaq kisha për procedurë. Faleminderit!

**Znj. I. Nano:** Zonja Vukaj.

**Znj. H. Vukaj:** Në vijim të shqetësimit që ngriti kolegu Çakaj, nuk mund të rri as pa e vijuar dhe as pa e prekur këtë procedurë, e cila na ka çuar tashmë të mendojmë që ky institucion është i degraduar dhe nuk ka më besueshmërinë tonën po e po, por nuk ka si të ketë as besueshmërinë e publikut për të gjitha eventet që kanë ndodhur një pas një jo vetëm këto ditët e fundit, ato i relatoi si më lart zoti Çakaj, dhe të gjitha janë të faktuara, por këto ishin një mbivendosje e të gjitha tentativave që janë bërë në këta katër vjet për të na zhbërë, për të na sfumuar si organ, një nga tre organet drejtuese të këtij institucioni, për të folur në emirin tonë, për të marrë kompetencat tona, për këtë pa dyshim, të nderuar qytetarë e ju media, që kemi bërë me dijeni edhe Kuvendin dhe u jemi adresuar me shqetësim të madh edhe organizatave që monitorojnë këtë proces, por nuk menduam se do të arrinim deri në këtë pikë, pra të manipulonin edhe rendin e ditës. Ne sot duhet të prisnim falënderim dhe përkushtim nga administrata për të na mbështetur në iniciativën e marrë, sepse në dijeninë tuaj duhet të bëjmë të qartë që ne jemi një trup, e cila nuk asistohet asnjëherë. Presumohet që administrata na asiston, por administrata nuk na ka asistuar ndonjëherë. Në momentin e vetëm kur ne kërkuam asistencën e administratës, administrata tregoi haptazi që jo vetëm ishte e njëanshme, por ishte e përfshirë në një skemë, e cila nuk ishte gjë tjetër veçse manipulim i një procesi, i një procedure, e cila ditën për diell është e qartë sepse është e parashikuar në Kod, në Rregullore, pra në të gjitha aktet që organizojnë dhe përcaktojnë mbarëvajtjen e saj. Pra, imagjinoni se sa të

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt. 30.01.2025*

guximshëm janë këta njerëz, të cilëve Kodi dhe taksat e qytetarëve, pra, publiku i ka besuar një proces kaq të rëndësishëm, vota, një e drejtë kushtetuese, e cila i jep mundësinë çdo qytetari të zgjedhë e të jetë i organizuar e i plotësuar në periudha të caktuara. Kjo është shumë e rëndë dhe e paprecedentë për institucione në një shtet demokratik. Unë nuk e di, në përvojën time, nuk kam hasur ndonjëherë raste të tilla, të cilat janë kaq manipulative dhe bëhen aty për aty e sy më sy. Pa diskutim që unë i bëj thirrje Komisionerit që duhet të marrë masa për këtë ngjarje dhe duhet të mbajë qëndrim për këtë ngjarje. Në mos, më bën të mendoj që kjo pa diskutim është një skemë e organizuar dhe e orkestruar.

**Znj. I. Nano:** Po, zoti Çakaj.

**Z. M. Çakaj:** Kisha edhe diçka. Për procedurë. Edhe në lidhje me propozimin e këtij akti, në Rregulloren për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit Rregullator, në pikën 11/6 kemi rënë dakord të miratojmë normën si më poshtë: “Në rastin kur mbledhja e Komisionit Rregullator nuk thirret nga Komisioneri, por thirret nga një ose disa anëtarë të Komisionit Rregullator, procedura që ndiqet është kjo: akti i nënshkruar regjistrohet në protokoll e më pas i dërgohet Sekretarit të Përgjithshëm të KQZ-së, i cili merr masa për njoftimin e anëtarëve të Rregullatorit, përfaqësuesve të subjekteve të përcaktuara në paragrafin 1 të nenit 8 të kësaj Rregulloreje dhe medias, pra përfaqësuesve të partive politike dhe medias.” Në rastin konkret na ka ardhur imeil nga zënjja Hoxhaj. Unë nuk e kuptoj, e para, Rregullorja është shkelur, e dyta, çfarë roli ka zonja Hoxhaj që na nis ne imeil për thirrjen e mbledhjes së Rregullatorit, për mbledhjen që e kemi kërkuar ne? Është shkelur Rregullorja në çdo nen, në çdo gërmë. Së dyti, edhe në Kodin Zgjedhor, edhe në Rregulloren e miratuar nga ne të pestë këtu, kemi rënë dakord që aty në atë tryezën e administratës do të jetë përfaqësues Sekretarja e Përgjithshme. Në 12 mbledhjet e fundit, vetëm 3 herë ka denjuar të vijë Sekretarja

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*

 5

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt. 30.01.2025*

e Përgjithshme. Mirë Komisioneri nuk vjen, por cili është shkaku ligjor që nuk paraqitet Sekretarja e Përgjithshme? Përpos faktit që Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka shkelur në mënyrë të përsëritur parashikimet e neneve 24 e 25 të Kodit Zgjedhor, të ndryshuar me ndryshimet e 26 korrikut 2024, ku parashikohet që aktet për votimin nga jashtë propozohen vetëm nga ai dhe sigurisht që duhet të mbrohen vetëm nga ai. Kjo situatë është totalisht e rëndë, e papranueshme dhe unë nuk gjej një shkak ligjor për të gjitha këto paligjshmëri në gjithë këto varg veprimesh të kryera si nga Komisioneri dhe nga administrata. Kështu që urgjentisht të merren masa për sjelljen në ligjshmëri të këtij institucioni, i cili po tregon dita-ditës që ka humbur besueshmërinë. Kjo është e provuar edhe në raportet e ODIHR-it, e nderuar, edhe në raportet e organizatave ndërkombëtare. Nga një institucion që pas zgjedhjeve të vitit 2021 ishte në vlerësimin më të lartë, vlerësimi ka rënë poshtë mesatares. Çfarë do të presim më? Kur të bjerë niveli i besimit poshtë zeros?

**Znj. I. Nano:** Po, zonja Vukaj.

**Znj. H. Vukaj:** Ne e kuptojmë faktin që në tentativën e herë pas hershme të Komisionerit, ka tentuar edhe të na shkrijë, të jetë institucion monokratik, por faleminderit besueshmërisë së Kuvendit, i cili ka vendosur të mos e shkrijë këtë mënyrë funksionaliteti për balancë, sepse këtu imagjinoni çfarë do të ishte bërë me një monokraci të tillë, ku të gjithë janë gati ndaj liderit të tyre, i cili e ushtron këtë funksion në mënyrë subjektive, sepse rastet flasin vetë. Kaq kisha për procedurë dhe transparencë karshi publikut. Nëse do të vijojmë me procesin, më thoni.

**Znj. I. Nano:** Po, zonja Doçaj. Pastaj zoti Nuri ka kërkuar fjalën.

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt. 30.01.2025*

**Znj. P. Doçaj:** Duke qenë se jam personi i përmendur nga anëtarët e Rregullatorit edhe për shkak të detyrës që mbaj, do të doja të risqaroja: të mos ngremë pluhur atje ku nuk ka, sepse janë dy veprime, të cilat nuk lidhen me njëra-tjetrën. Ashtu sikurse e kemi konsultuar edhe në zyrë me të gjithë ju, në momentin kur më kanë thirrur dy nga anëtarët e Komisionit për të hartuar një shkresë përcjellëse për thirrjen e mbledhjes dhe më pas për të bashkëlidhur edhe projektvendimin së bashku me relacionin, kam cituar përpara jush që edhe Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka përgatitur një akt që do t'i njoftohet për njohje Komisionit Rregullator. Nga thirrja e mbledhjes në njohjen e aktit janë dy gjëra të ndryshme, pra thërritja për mbledhjen e Rregullatorit është bërë në bazë të Kodit Zgjedhor dhe në bazë të Rregullore suaj, akti i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve është një akt, i cili ju është bërë me dije për njohje, pra nuk ju kemi thërritur për mbledhje. Pra, këtu duhet të sqarojmë këtë pjesë dhe janë dy gjëra të ndryshme për sa i përket pjesës procedurale.

Për sa i përket akuzës që njëri nga anëtarët më bën drejtpërdrejt mua si Pavlina Doçaj, dua të citoj përpara jush që akti është nënshkruar në praninë time, është depozituar në protokollin e KQZ-së gjysmë ore ose 40 minuta më pas, është skanuar dhe është hedhur në EDMS dhe i është bërë me dije Komisionerit, ashtu sikurse thekson neni 11, pika 6, pra në rastet kur mbledhja nuk është vënë në lëvizje nga Komisioneri sipas përcaktimeve të Kodit, kopja e njoftimit dhe aktet fillimisht i dërgohen paraprakisht Komisionerit. Kjo rrugë është ndjekur. Pra, i është dërguar me EDMS Komisionerit dhe më pas u është dërguar të gjithë përfaqësuesve politikë dhe OJF-ve. Në orën 4:24 ky vendim, pra vendimi që Komisioneri ju bën me dije, ju është dërguar juve për njohje, përfaqësuesve politikë dhe OJF-ve. Në orën 4.38 është përcjellë tek Rregullatori. Pra, flasim për aktin e Komisionerit.

Për sa i përket shkresës që përmban edhe aktet e Komisionit Rregullator për mbledhje, është dërguar në orën 4:44. Patjetër që ka ndodhur një lapsus në

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*

 7

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt. 30.01.2025*

dërgimin e këtij imeili nga zëdhënësja, e cila ka qenë e autorizuar për të bërë të gjitha njoftimet jo vetëm partive politike, OJF-ve, por edhe organeve drejtuese, duke qenë se Sekretari i Përgjithshëm me një raport paaftësie nuk ka mundur të jetë aktiv jo vetëm në punë, por edhe në rrjete sociale. Ka qenë në pamundësi shëndetësore për të kryer detyrën funksionale. Duke qenë se jemi në kushtet kur ky raport justifikon më së miri Sekretarin e Përgjithshëm, KQZ-në e përfaqëson, mjafton të jetë i autorizuar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, edhe një person i administratës. Unë nuk shoh këtu asnjë shkelje procedurale të kryer nga ana ime. Do të kisha vepruar po në të njëjtën mënyrë edhe në rast se do të ripërsëritej e njëjta gjë, madje me njërin nga anëtarët kam kontaktuar në orën 4:22 në telefon dhe i kam kërkuar shprehimisht nëse i donin të skanuara ose në format *word* materialet për t'ua përcjellë partive politike dhe cili është afati që do t'u lëmë në dispozicion partive politike dhe OJF-ve për të shprehur mendimin e tyre. Kemi folur në orën 4.22. Nuk shoh ndonjë shkelje procedurale të bërë nga administrata, as me qëllim dhe as pa qëllim. Është në gjykimin tuaj që të...

**Znj. I. Nano:** Po, zoti Çakaj.

**Z. M. Çakaj:** Mund të sqarojmë diçka? Ju e pranuat që është firmosur shkresa për thirrjen e mbledhjes së Komisionit Rregullator në zyrën tonë, në prani të dy anëtarëve. Në praninë time dhe të zonjës Vukaj. Përpara ju kishim nisur imeil në orën 14:45...

**Znj. P. Doçaj:** Ma nisët më pas, më nisët një që ishte gabim, pastaj më nisët një të dytë.

**Z. M. Çakaj:** 14.45. Janë prova zyrtare, nuk i shmangim dot dhe 5 apo 10 minuta më pas keni printuar kërkesën dhe e keni protokolluar.

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*





**Znj. P. Doçaj:** Kërkesa është hartuar nga ana ime.

**Z. M. Çakaj:** Po, po, nga ana juaj, e nderuar. E di pse është printuar nga juaj? Se nuk na punojnë printerat ne. Ne që kemi...

**Znj. P. Doçaj:** Dakord.

**Z. M. Çakaj:** Të lutem, se po flas. Nervozizmin mbajeni atje.

**Znj. P. Doçaj:** Nuk kam nervozizëm.

**Z. M. Çakaj:** Këtu përgjigjuni. Nëse nuk keni përgjigje, atëherë, ju lutem. Në orën 14.45 që e kemi dërguar kërkesën, supozojmë që çerek ore më pas e keni printuar, se ne nuk na punojnë printerët. Kemi lekë për votim numërim elektronik, kemi miliona euro, por nuk kemi lekë për dy printerë. Meqë keni marr autorizimin, do të më paraqisni autorizimin edhe ju, edhe zonja Hoxha.

**Znj. H. Vukaj:** Ju duhet të zbatoni rregulloren t'i jepni vërejtje zonjës, sepse i mbivendoset anëtarit të Komisionit Rregullator.

**Z. M. Çakaj:** Çfarë ka ndodhur, supozojmë, jo një 1 orë gjysmë, por një orë e çerek nga kati i dytë në katin e parë që ju nuk e keni dorëzuar kërkesën tonë në protokoll? Çfarë ka ndodhur, e nderuar? Kaq. Pse nuk e keni protokolluar kërkesën kur e kemi nënshkruar ne, por e keni vonuar 1 orë e çerek.

**Znj. P. Doçaj:** Është protokolluar menjëherë.

**Z. M. Çakaj:** Jo, nuk është protokolluar menjëherë.

**Znj. P. Doçaj:** Është protokolluar gjysmë ore më pas.

**Z. M. Çakaj:** Jo, nuk është protokolluar gjysmë ore më pas.

**Znj. P. Doçaj:** Nuk e kam çuar vetë personalisht, kam dërguar një person të stafit për ta çuar atje ku duhet çuar.

**Z. M. Çakaj:** Atëherë, porosia e dy anëtarëve të Komisionit Rregullator ka qenë protokollojeni dhe niseni.

**Znj. P. Doçaj:** Patjetër. Atë gjë kam bërë.

**Z. M. Çakaj:** Ju mund ta bënit edhe të nesërmen.

**Znj. P. Doçaj:** E kam bërë në të njëjtën datë...

**Z. M. Çakaj:** E njëjta datë është nga ora 8 e mëngjesit deri në orën...

**Znj. P. Doçaj:** Nuk më është lënë një afat caktuar që merre dhe çoje menjëherë. Më keni thënë këtë shkresë depozitojeni në Protokoll.

**Znj. H. Vukaj:** Ne po prisnim në zyrë të na e konfirmonit që po, e çuat.

**Znj. P. Doçaj:** E nënshtruat, ma latë në dorë dhe më thatë... Nuk më latë një orar, brenda 20 minutave.

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt. 30.01.2025*

**Z. M. Çakaj:** Të lutem, ju mund të bëni...

**Znj. P. Doçaj:** Nuk është makinacion, e para.

**Z. M. Çakaj:** Të lutem, ju mund të bëni çfarë të doni. Problemi qëndron këtu...

**Znj. P. Doçaj:** Unë nuk shoh të ketë prodhuar ndonjë efekt. Shkak-pasoja këtu nuk ekziston.

**Z. M. Çakaj:** Kjo ndarja “akt për njohje” me vetëthirrje, por me mbivendosje me vendimin nr. 9 është totalisht...

**Znj. I. Nano:** Mos ndërprisni njëri-tjetrin. Të mbarojë njëri, pastaj tjetri.

**Z. M. Çakaj:** Kjo situata me mbivendosje për ne është manipulim. Për ju, sigurisht që ju jeni aktorët e këtij procesi së bashku me Komisionerin, sigurisht që nuk do të jetë manipulim, por për ne është manipulim dhe këtë thirrje kam unë: kur tentohet të manipulohet rendi i ditës dhe projektvendimi për mbledhjen e thirrur nga dy anëtarë të Rregullatorit, çfarë ndodh me votën e shqiptarëve? Çfarë ndodh me kërkesat për regjistrim të emigrantëve? Shih, sa është numri! Refuzuar 36%. Kjo është KQZ-ja. Të marrë masat edhe Kuvendi, edhe organizatat ndërkombëtare, ta shikojnë mirë situatën se çfarë ndodh.

**Znj. P. Doçaj:** A mund të saktësoj diçka?

**Znj. H. Vukaj:** Të lutem, jemi koherentë edhe me çfarë ka bërë administrata dhe faktet janë këtu. Sa për transparencë, vendimi nr.9 i vitit 2020, i cili ka të bëjë me

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt. 30.01.2025*

organizimin dhe raportimin e veprimtarive të ndaluara, është një nga vendimet kryesore të këtij procesi, sepse ka për qëllim pandikueshmërinë, “armët e barabarta” në zgjedhje të subjekteve zgjedhore e kështu me radhë. Ky vendim është tentuar disa herë nga ne që për hir të nevojës, për hir të raporteve të OSBE-ODIHR-it, për hir të shumë precedentëve të hasur në secilën palë zgjedhje që kemi kaluar gjatë kësaj periudhe dhe ka qenë domosdoshmëri ndërhyrja në të. Ju propozuar në dhjetor një paketë ndryshimesh, e cila në kuadër të shqyrtimit të saj u servir se ishte një domosdoshmëri institucionale për hir të asaj platformës ku institucionet kanë detyrimin të raportojnë. E mirëkuptuam këtë dhe kushtëzuam, sepse e pamë të arsyeshme që nuk mund të bëjmë ndryshime dy herë në këtë akt në momentin kur ky akt duhet të preket nga fillimi në fund për të qenë efektiv dhe i dobishëm për procesin. Nevoja ishte therëse për ndryshime dhe plotësime në këtë akt. Na thatë që po, bëjmë këto ndryshime së paku, për hir të platformës dhe nxitjes së institucioneve që duhet të raportojnë dhe ky raportim nuk duhet të shkojë bosh dhe më pas ne jemi duke punuar për pjesën tjetër. Në mirëkuptim dhe konstruktivitet ju besuam dhe shqyrtuam, analizuam, vlerësuam dhe votuam ndryshimet e propozuara, sigurisht duke pritur ndryshimet e tjera. Herë pas here kam pyetur: a janë gati ndryshimet e tjera për hir të kushtëzimit, për hir të të bërit publik dhe për hir të nevojës që kishte vendimi nr. 9 i vitit 2020 për t’u plotësuar, ndryshuar e shtuar. Më thatë që nuk e kemi gati paketën apo ndryshimet e tjera më 15 janar të vitit 2025. Si rrjedhojë, duke parë që veprimtaritë e ndaluara po ushtroheshin megalop si brenda dhe jashtë vendit, ndërkohë incentivimi nga ana e KQZ-së as kryesisht, as në meritë të detyrimeve që përcakton Kodi apo të gjitha aktet e tjera normative, ishte në rol pasiv, ndërmorëm ne dy anëtarët e Komisionit Rregullator iniciativën me premisën legjitime që na e jep Kodi, të bëjmë këto shtesa e ndryshime. Kjo është transparenca, të nderuar ju, që na ndiqni në sallë e përtej sallës dhe media e nderuar, që të dijë në linjë kronologjike se çfarë ka ndodhur. Në momentin kur ju morët vesh që dy anëtarët kishin përgatitur këto

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt. 30.01.2025*

ndryshime, për të justifikuar mungesën e aktivizimit, pra të rolit proaktiv të KQZ-së dhe të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve gjatë kësaj periudhe, por njëkohësisht edhe të kushtit të papërmbushur deri në datën 15 janar 2025, u incentivuat dhe gjetët një formë për të na vënë ndoshta në atë pritën që shiko, se kemi edhe ne disa ndryshime. Ndërkohë që ndryshimet deri në atë moment nuk kishin ardhur, as për njohje dhe as në ndonjë format tjetër, madje u insistua që këto ndryshime ishin kaq gati, sa që mund edhe të bashkoheshin. Insistuaam dhe thamë: ndryshimet e Komisionerit, për sa kohë nuk erdhën në datën 10 janar 2025, kur fillon edhe efekti 4 muaj para zgjedhjeve, atëherë ç'efekt ka? Dhe në këtë kuadër ju thamë, zonjë, çoni këto, incentivoni për procedurë formatin dhe shkresat tona dhe më pas Komisioneri, pasi t'i shqyrtojë ose pasi të na i propozojë formalisht ose jo formalisht, apo gjysmë formalisht, i diskutojmë edhe ato të Komisionerit. Kjo skemë është bërë në kuadër dhe meritë të prevalencës së propozimeve të Komisionerit në raport me tonat. Pse-në jua sqarova më lart: për të justifikuar rolin e tij joaktiv dhe për të justifikuar atë çfarë ju mohuat me gojën tuaj në mbledhjen e datës 15 janar 2025. Kjo ka qenë rezymeja për transparencë e gjithë rendit kronologjik çfarë ka ndodhur në këtë institucion. Sot, në fakt, jemi mbledhur për të shqyrtuar, ftoj kolegët të kenë bonsensin jo vetëm të dëgjesës, por edhe të marrjes në konsideratë të çfarë kemi punuar në meritë edhe të konstatimeve të raporteve të OSBE-ODIHR-it, të këtij projektakti, i cili në mendësinë tonë plotëson disa boshllëqet që do të japin impakt patjetër në rolin e vënies së balancës midis palëve apo midis garuesve në datën 11 maj 2025. Kështu që, zonja Nano, nëse procedura është gati për t'u relatuar, mjafton të më thoni.

**Znj. I. Nano:** Kishte kërkuar fjalën zoti Nuri. Për procedurë, besoj.

**Z. F. Nuri:** Po, për procedurë e kisha. Si përfaqësues i Partisë Demokratike doja të mbaja një qëndrim të shkurtër në lidhje me sa dëgjuam deri tani. Ajo që po

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*

 13

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt. 30.01.2025*

shohim është një situatë goxha serioze, kërkojmë të bëhet transparencë maksimale me ç'ka ndodhur në lidhje me shqetësimet e ngritura nga dy anëtarë të Komisionit Rregullator, zonja Vukaj dhe zoti Çakaj, është e patolerueshme të ndodhin episode të tilla brenda institucionit të KQZ-së, aq më tepër në këtë moment deciziv për votën e diasporës ku kërkohet besueshmëria maksimale, në vlerësimin tonë si aktor politikë dhe subjekt politik, të interesuar në procesin e zgjedhjeve të majit 2025. Të gjitha këto veprime e cenojnë besueshmërinë e publikut të KQZ-ja, ndaj do të duhet të behët transparenca maksimale dhe të sqarohet se çfarë ka ndodhur në mënyrë që të mos përsëriten ngjarje të tilla, sepse, tek fundit, për çfarë po flitet. Po flitet për mungesën e akti administrativ, që duhet të ishte i plotë më 10 janar 2025. Pse? Sepse katër muaj para zgjedhjeve duhet të ishin të qarta të gjitha ndalimet e mundshme të aktiviteteve të ndaluara pikërisht që nuk duheshin kryer nga administrata publike dhe për faktin që mungon iniciativa nga ana e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, u desh dhe shihet e domosdoshme ndërhyrja e vetë Komisionit Rregullator për të propozuar ndryshime, plotësime, amendime të aktit nr. 9 për të shmangur këto situata. Unë uroj që situata të tilla të mos përsëriten në të ardhmen, të sqarohet se çfarë ka ndodhur, të bëhet transparencë e plotë e këtij episodi dhe uroj që edhe akti të plotësohet me të gjitha ato mangësi që mund të ketë, sa më shpejt të jetë e mundur, sepse edhe këto ditë dhe javë që janë humbur, janë tejet të rëndësishme dhe ndikojnë në procesin zgjedhor.

**Znj. I. Nano:** Faleminderit, zoti Nuri! Fillojmë me shqyrtimin e projektaktit. Çështje jashtë rendit të ditës nuk e di nëse kishte. Meqenëse akti është propozuar nga dy anëtarë të Komisionit Rregullator, kush dëshiron të relatojë lidhur me përmbajtjen e tij? Zonja Vukaj.

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt. 30.01.2025*

*Znj. H. Vukaj:* Do të relatoj unë, pavarësisht se draftakti është realizuar nga të dy ne anëtarët, unë dhe zoti Muharrem Çakaj. Faleminderit! Po relatoj në lidhje me projektvendimin që kemi propozuar “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, i cili pësoi ndryshimet e para pas katër viteve, në dhjetor të 2024. Titulli i këtij akti është “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve. Për sa i përket vlerësimit të ligjshmërisë dhe harmonizimit me legjislacionin, ne dy anëtarët e Komisionit Rregullator, gjejmë mbështetje në nenin 12, pika 4 dhe nenin 20, pika 1, si dhe nenin 91 të Kodit Zgjedhor të ndryshuar. Për sa i përket nenit 12, pika 4 e Kodit Zgjedhor përcakton se Komisioni Rregullator është organi kompetent për miratimin e akteve me karakter normativ në fushën e zgjedhjeve dhe vendosjen e rregullave për zgjedhjet. Ndërsa referenca tjetër, neni 20, pika 1, shkronja “a” e Kodit Zgjedhor, parashikon kompetencën e Komisionit Rregullator për miratimin e projektaktit me karakter normativ, të përgatitur nga administrata e KQZ-së ose nga anëtarët e tij. Pra, në këtë rast, akti është përgatitur nga ne anëtarët e Komisionit Rregullator. Për sa i përket dispozitës materiale, të cilës do t’i referohemi në propozimet që kemi bërë, është neni 91, me titull “Ndalimi i përdorimit të burimeve publike në mbështetje të subjekteve zgjedhore”, i cili ka pësuar ndryshime përmes ligjit nr. 101/2020, datë 23.7.2020. Pra, kjo është dispozita materiale e cila nevojitet të sistemohet dhe përshtatet në mënyrë më të qartë e sipas problematikave të referuara në raportet e OSBE/ODHIR. Komisioni Rregullator në fillim të mandatit të tij., kjo është një përmbledhje në lidhje me aktin, se çfarë ka ndodhur me aktin bazë. ...në zbatim të neneve 91 dhe 92 të Kodit Zgjedhor, me qëllim vendosjen e rregullave/normave për

*Zbardhi materialin audio  
Areta DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt. 30.01.2025*

të pasur një proces zgjedhor të pandikuar nga aktorë dhe faktorë të njëanshëm në administrim të intitucioneve publike si: asetet publike, financat publike, administrata publike dhe çdo instrument apo mekanizëm me impakt në prishjen e standartit të zgjedhjeve të lira e të ndershme, si dhe me synimin për të vendosur barazimin e “armëve” në një proces zgjedhor, që siç ka rezultuar deri tani është një synim utopik për vendin tonë, miratoi Vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 “Për Rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”. Vendimi nr. 9/2020, materializon parashikimet e neneve 91 dhe 92 të Kodit Zgjedhor. Qëllimi i miratimit të këtij akti duhej të ishte rregullimi dhe disiplinimi i veprimtarisë së gjithë institucioneve shtetërore në periudhën 4 muaj përpara e deri në ditën e zgjedhjeve. Në kujtesë të nderuar kolegë, Vendimi nr. 9/2020 është miratuar, së pari në një periudhë dinamike aktformuese dhe të vështirë në shumë drejtime, mbi të gjitha në drejtim të anës shëndetësore, për shkak të përhapjes së virusit Sars-Covid. Së dyti, është miratuar pas dekretit të Presidentit të Republikës i cili shpallte si datë për zhvillimin e zgjedhjeve të përgjithshme për Kuvendin e Shqipërisë, datën 25 Prill 2021. Qëllimi i këtij akti ka qenë vendosja e rregullave në funksion të marrjes së masave, monitorimit dhe parandalimit të veprimtarive të ndaluara, sjelljes apo përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të institucioneve qendrore e vendore, si dhe të administratës shtetërore, gjatë periudhës kohore 4 muaj para zgjedhjeve deri në datën e zgjedhjeve. Kjo synonte garantimin dhe sigurimin e paanshmërisë dhe trajtimit të barabartë të kandidatëve dhe të partive politike, krijimin e kushteve të drejta e të barabarta për të gjithë kandidatët dhe partitë politike që marrin pjesë në procesin zgjedhor, si dhe për mospërdorimin e fondeve dhe të

*Zbardhi materialin audio  
Areta DULAKU*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt. 30.01.2025*

burimeve publike për qëllime partiake. Qartazi, Kuvendi në miratimin e ndryshimeve në Kodin Zgjedhor, ka vendosur kufirin 4 muaj përpara datës së zgjedhjeve, duke u prirë nga parimet kushtetuese për të realizuar zgjedhje të lira e të pandikuara si dhe nën suazën e mbivalencës dhe avantazhit të pasjes pushtet dhe peshë nga ana e një force politike përpara datës së zgjedhjeve. Në këtë kontekst, do të ishte e nevojshme që partia e cila ka pushtetin të mos e shfrytëzonte as në “mala fede” këtë parashikim ligjor dhe as “majë më majë” dhe për hir të përkimit të pak ditëve më tepër mbi afatin 4 mujor të tregonte mungesë përgjegjshmërie duke miratuar konkretisht nisma dhe akte ligjore e nënligjore me qëllim ndikimin e drejtëpërdrejtë elektoral. Në fakt kështu ka ndodhur si përpara zgjedhjeve për Kuvendin të vitit 2021. Kujtojmë këtu keqpërdorjen për efekt elektoral të ndarjes së banesave të reja për shkak të strehimit në to të banorëve të mbetur të pastrehë nga tërmeti i vitit 2019, kryesisht të zonës Durrës, Thumanë, Fushë Krujë, etj. Premtimin për rritjen e pensioneve, shpërndarjen e parave për banesat e dëmtuara nga tërmeti në zonën e Durrësit, etj. Po ashtu edhe përpara zgjedhjeve të përgjithshme vendore të vitit 2023. Kujtojmë këtu premtimin e kryeministrit përpara zgjedhjeve mars 2023 për rritjen e pagave të administratës. Fatkeqësisht e njëjta situatë e paligjshme po ndodh edhe përpara zgjedhjeve të datës 11 Maj 2025. Konkretisht më poshtë gjeni të renditura aktet konkrete: Të tilla si:...

**Z. M. Çakaj:** Atëherë, po e vazhdoj unë relacionin. Konkretisht ne kemi renditur disa akte konkrete, të cilat në gjykimin tonë kanë qenë veprimtari të ndaluara dhe konkretisht:

a) Vendimi i ERE datë 08.01.2025 për “uljen e çmimit të energjisë”. Pavarësisht se data e miratimit të këtij vendimi, nga pikëpamja formale, rezulton tre ditë jashtë afatit 11 janar, pra jashtë afatit të periudhës 4 mujore të ndalimit. Dukshëm ky është

*Zbardhi materialin audio  
Areta DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt. 30.01.2025*

një vendim, i cili synon të marrë avantazhe të padrejta elektorale dhe si synim të përgjithshëm ka përfitimin elektoral duke përdorur burime shtetërore të qeverisë për zgjedhjet e përgjithshme për Kuvendin të datës 11 maj.

b) Akti normativ i Qeverisë “Për bonusin e pranverës për pensionistët” i cili, pavarësisht se është miratuar në dhjetor 2024, fakt është që efektin e jep në prill 2025, pra një muaj para zgjedhjeve. Ky dukshëm është një akt, një veprim i ndaluar. Është një akt i cili jep avantazhe favorizuese të paligjshme qeverisë, në raport me partitë e tjera garuese.

c) Disbursimi i 501 milion dollarë nga buxheti i shtetit drejt klientëve buxhetorë vetëm në 10 ditët e para të muajit janar 2025, nga thesari i Shqipërisë. Fakti që vetëm në 10 ditët e para të janarit 2025 është disbursuar kjo shumë, automatikisht dyshimi i arsyeshëm është që kemi të bëjmë me përdorimin masiv të fondeve shtetërore për.. Për çfarë? Për të marrë avantazhe të padrejta për qëllime elektorale. Për më tepër kemi dhe Vendimin nr. 21, datë 9 janar 2025, i cili ka hyrë në fuqi në datë 17 janar 2025, këtë e gjeni në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë nr.10, është vendim i Këshillit të Ministrave me anën e të cilit janë miratuar kuota të përgjithshme të kredive të reja për 530 punonjës të administratës publike shtetërore. Në këtë moment gjej rastin të bëj dhe një denoncim konkret. Ta marrë KQZ-ja, ta shqyrtojë si veprimtari të ndaluar këtë. E ka fuqinë ligjore në bazë të Kodit Zgjedhor që, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 21, datë 9 janar, i cili ka hyrë në fuqi dhe ka prodhuar efekt në datën 17 janar është veprimtari e ndaluar, pasi përkon me periudhën 4 mujore. Këtu qartazi kemi të bëjmë me një veprimtari të ndaluar. Të mos dalin atje e të thonë që “s’kemi denoncime”. Ja ky është një denoncim konkret. Pavarësisht se nga pikëpamja formale procedurale aktet e miratuara nga qeveria janë në disa raste një muaj përpara, ose në disa raste të tjera vetëm disa orë përpara, 24, 48, apo 72 orë përpara afatit 4 mujor, të gjitha këto vendime të qeverisë e japin

*Zbardhi materialin audio  
Areta DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt. 30.01.2025*

efektin dhe pasojën brenda periudhës 4 mujore. Ky fakt është i ndaluar nga neni 91 i Kodit Zgjedhor si dhe nga Vendimi nr. 9/2020 i Komisionit Rregullator duke përbërë qartazi avantazhe elektorale të padrejta apo keqpërdorime të burimeve shtetërore në favor të partisë në pushtet. Në këtë kuadër, për vetë ndikimin e padrejtë që japin këto urdhërime/vendime të qeverisë e në analizë dhe interpretim të dispozitave referuese mbi bazën e të cilave ngrihet përmbajtja e Vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, nuk duhet kurrësesi që veprimtaritë publike vendimmarëse të kushtëzohen “prima facie” ose në dukje vetëm nga afati 4 mujor, apo në rastin e veprimtarive të tjera nga afati 1 mujor i fushatës zgjedhore. Sot, në vlerësimin dhe bindjen tonë rezulton se është tejet e nevojshme që jo vetëm normat e Vendimit nr. 9/2020 duhet t’i nënshtrohen vetëm parimit kushtetues për të garantuar zgjedhje të lira e të pandikuara dhe ndaj në këtë kuadër, të gjendur edhe para faktit të ekzistencës së një force politike e cila merr mbivalencë dhe avantazhe për hir të pasjes pushtet dhe forcë përpara ditës së zgjedhjeve, por duhet të merret në konsideratë që ky avantazh duhet të ngrijë që në momentin e shpalljes së dekretit të Presidentit të Republikës për caktimin e datës së zgjedhjeve. E thënë ndryshe, forca politike që drejton vendin, për hir të barazisë në zgjedhje, duhet të jetë koshiente për supremacinë e saj në garë. Në këto rrethana në një shtet me parime minimale demokratike duhej të mosndërmarrë akte apo veprime të cilat synojnë, apo i japin privilegje kategorive të ndryshme të popullatës në fund të mandatit të saj qeverisës, me qëllimin e qartë për të përfituar avantazhe elektorale. Në vlerësimin tonë, keqpërdorimi i burimeve shtetërore, së bashku me vjedhjen e votës janë vrasësit e zgjedhjeve të lira e të ndershme. Pa zgjedhje të lira e të ndershme nuk ka demokraci. Për fat të keq në të njëjtin konstatim të përbashkët me tonin “vrastar për demokracinë” kanë arritur edhe organizatat kombëtare e ndërkombëtare të cilat operojnë në fushën e zgjedhjeve. Siç jeni në dijeni, nga data e miratimit të këtij akti,

*Zbardhi materialin audio  
Areta DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt. 30.01.2025*

pra Vendimit nr. 9/2020 e deri më sot, në Shqipëri janë zhvilluar disa procese zgjedhore. Përmendim këtu zgjedhjet e përgjithshme 25 prill 2021. Zgjedhjet e përgjithshme vendore 14 maj 2023. Zgjedhjet e pjesshme vendore 6 mars 2022. Procesi zgjedhor për zgjedhjet e përsëritura për kryetar Bashkie Rrogozhinë 23 korrik 2023. Më lejoni të ndalem pak, ky është rasti tipik i keqpërdorimit kriminal të burimeve shtetërore për avantazhe të paligjshme elektorale, ku gjithë Bashkia e Tiranës, të gjithë drejtorët e Bashkisë Tiranë me në krye kryetarin e bashkisë, Erion Veliqaj, i cili e kishte sfidë personale, shkuan në Rrogozhinë dhe dhanë atë rezultat të manipuluar, të turpshëm elektoral. Pra, nga diferenca 20 vota, e çuan në 1500. Mund ta çojnë dhe 15000 patjetër, pse të mos e çojnë?! I kanë të gjitha burimet shtetërore. Për të mos folur pastaj për zgjedhjet e pjesshme për kryetar Bashkie Himarë të 4 gushtit 2024, ku paligjshmëria filloi që nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Që nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, i cili e dinte para nesh të gjithëve, e dinte edhe datën se kur do të ishte dhe bëri namin këtu pse i ndryshoi me një ditë. Pse ju dha një ditë përfaqësuesit të ish kryetarit të bashkisë të mbetur në tentativë, ju dha një ditë më tepër për të pasur dhe ai parimin e kontradiktoritetit, për të pasur dhe ai për ta quajtur procesi i rregullt ligjor. Kjo është e turpshme. Referuar të gjithë raporteve të organizatave vendase e të huaja vëzhguese në proceset zgjedhore, veçanërisht referuar raporteve të Misionit të OSBE/ODIHR, ka rezultuar se: Keqpërdorimi i burimeve dhe asetëve shtetërore është një nga elementët më thelbësorë në ndikimin e rezultatit zgjedhor. Më konkretisht sjellim në vëmendjen tuaj, të nderuar kolegë se, në Raportin Përfundimtar të OSBE/ODIHR për zgjedhjet e përgjithshme për Kuvendin të vitit 2021, që në faqen e parë citohet, po perifrazoj se çfarë ka shkruar ODIHR-i, “Partia qeverisëse përfitoi avantazhe të rëndësishme nga të qenit në pushtet, duke përfshirë edhe përmes kontrollit të administratave lokale dhe shpërdorimit të burimeve administrative. Kjo u amplifikua edhe nga

*Zbardhi materialin audio  
Areta DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt. 30.01.2025*

mbulimi pozitiv i institucioneve shtetërore në media”. Pra këtu, jo vetëm përdoren burimet shtetërore, jo vetëm përdoren burimet njerëzore, po këtu dhe media e cilëson si sukses, 80, 90% e medias. Më tej akoma, në Raportin Përfundimtar të OSBE/ODIHR për zgjedhjet e përgjithshme vendore të vitit 2023, përsëri në faqen e parë ka mbetur shënimi kryesor dhe më lejoni ta citoj, “Rastet e keqpërdorimit të burimeve shtetërore në nivel qendror dhe vendor, pretendimet për presion mbi punonjësit e sektorit publik dhe zgjedhësit dhe pretendimet për blerje votash ishin shqetësuese”. Pra, kur janë shqetësuese për partnerët tanë ndërkombëtarë, këtu janë ulëritëse. Po kështu edhe një sërë organizatash kombëtare që operojnë në fushën e zgjedhjeve dhe këtu veçanërisht dua të nënvizoj organizatën KRIIK, e cila merr pjesë rregullisht edhe në mbledhjet tona, ka denoncuar në mënyrë permanente dhe vazhdimisht keqpërdorimin e burimeve shtetërore duke marrë avantazhe të padrejta nga partia në pushtet, në procesin zgjedhor. Të nderuar kolegë, vlen të theksojmë faktin se ndaj Vendimit nr. 9/2020 patën pritshmëri të gjithë aktorët e pavaruar dhe subjektet jo pushtetmbajtës, që ky akt të ishte një barrierë ligjore dhe referencë normuese për të gjitha insitucionet shtetërore e publike të të gjitha niveleve dhe kategorive, ndërkohë që u pa dhe ishim dëshmitarë të faktit se si ndodhi e kundërta. Nga zbatimi në praktikë u konstatua gjerësisht, kombëtarisht e ndërkombëtarisht, përmes denoncimeve dhe raporteve publike të organizatave vendase e të huaja vëzhguese në këtë drejtim, se jo vetëm ky akt u shkel dhe u neglizhua, por në shumë raste nuk u zbatua fare. Pra, ishte thjesht një akt formal. Ligje kemi, po nuk zbatohen. Përpos sa mësipër, në kuadër të ndryshimeve të reja në Kodin Zgjedhor, kur për herë të parë në procesin zgjedhor përfshihen zgjedhësit nga jashtë, në vlerësimin tonë, dy anëtarëve propozues, lind nevoja emergjente për shtesa e ndryshime në Vendimin nr. 9/2020 në përshtatje me këto amendime të Kodit Zgjedhor. Pra, koncepti i veprimtarive të ndaluara, të përfshihen edhe në veprimtaritë publike që zhvillohen

*Zbardhi materialin audio  
Areta DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt. 30.01.2025*

jashtë vendit. Rrethanat dëshmojnë qartë se që nga data 11 janar, datë në të cilën sipas leximit që i bëjnë anëtarët e forcës politike në pushtet Vendimit nr. 9/20220 fillojnë efektet e zbatimit të vendimit për ndalimin e keqpërdorimit të burimeve shtetërore dhe raportimin e veprimtarive me karakter publik, e deri më sot, rezulton se kemi një sërë veprimtarish të ndaluara, apo keqpërdorime të burimeve shtetërore të kryera edhe jashtë vendit. Këtu përmendim rastin e kreut të Bashkisë Fier, Armando Subashi, me aktivitetin për emigrantën në Greqi. Kemi rastin e ministrit Balla. Kemi rastin e kreut të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, zotit Peleshi për ngritjen e një zyre aplikimesh dhe sigurisht edhe marrjen e attributeve të KQZ-së, por edhe përfshirjen e të gjithë drejtorëve të administratës së Bashkisë Korçë, apo më gjerë dhe ngritjen e një zyre aplikimesh për regjistrim pranë Konsullatës Shqiptare në Selanik, duke marrë edhe tagrin e KQZ. Pra, para disa ditësh po dëgjoja në intervistë edhe deklarin e zotit Klosi, i cili me zë dhe më figurë ka deklaruar se nuk mjafton vetëm KQZ, nuk është e aftë KQZ të bindë votuesin nga jashtë, apo të edukojë se si regjistrohen. Madje dhe PD-ja ka ngritur grup pune. Kjo është ulëritëse, gjithë këto fonde që administrojnë KQZ-ja dhe të mos jemi të aftë të informojmë, edukojmë zgjedhësit se si të regjistrohen. Është e pamundur të regjistrohesh. Madje, madje, se po kalojmë në nivele gojëdhëne, se nuk e kemi të provuar. Në disa vende, nisur nga vullneti dhe dëshira e madhe e zgjedhësve shqiptarë për t'u regjistruar, kanë dalë dhe aplikime, si për llotarinë amerikane, 5 euro të regjistrohesh, të regjistroj unë. Aq e vështirë është bërë PER-i. E kuptoni çfarë kemi bërë me këtë PER-in?! 5 euro, ka dalë, ka hapur zyrë, biznes për t'u regjistruar si votues nga jashtë. Turp i Zotit! Krahas këtyre, një arsye shtesë për ndryshimin e Vendimit nr. 9/2020 imponon dhe vendimmarrja e deritanishme e organit tjetër drejtues të KQZ siç është KAS, i cili në vendimmarrjet e tij të herë pas herëshme, në të gjitha analizat vjetore që ne kemi zhvilluar, ka konstatuar një vakum ligjor lidhur me mos

*Zbardhi materialin audio  
Areta DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt. 30.01.2025*

përcaktueshmërinë e unifikuar të afatit mosushtrimor të veprimtarive publike me efekt elektoral apo publik 4 mujor, në Vendimin nr. 9. Më konkretisht neni 3 “Veprimtari të ndaluara”, pika 1.3, shkronja “c”. Ky fakt është evidentuar në të gjitha vendimarrjet e KAS, ku kolegët e KAS nuk kanë arritur dot në një vendimarrje pasi e interpretojnë në mënyra të ndryshme këtë përcaktim, këtë normë, që sipas gjykimit të tyre ka vakum ligjor. Ne kemi propozuar zgjidhjen e kësaj norme. Pra, riformulimin e kësaj norme duke identifikuar afatin 4 mujor si normë, datë nga e cila më pas do të konsiderohet veprimtari e ndaluar. Referuar gjithë sa më sipër u relatua, rezulton e qartë se nevoja për ndryshime në aktin nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator është domosdoshmëri, në mënyrë që një proces zgjedhor të jetë i lirë, i barabartë dhe i drejtë dhe palët garuese të garojnë në mënyrë të ndershme e të barabartë. E nëse ndonjë prej palëve garuese qartësisht, në gjykimin dhe vlerësimin tonë, pala e cila ka pushtetin vazhdues nuk e koncepton dot “garimin në kushte të barabarta”, atëhere do të duhet që ky “koncept i paligjshëm” të normohet e t’i jepet fund pikërisht me këto propozimet tona, me këtë kuadër rregullator. Në këto kushte, për hir të mundësisë incentivuese e nismëmarrëse që ligjvënësi na ka afruar në Kodin Zgjedhor, na lind përgjegjësia të marrim masat e nevojshme përmes mekanizmit të vënies në lëvizje të Komisionit Rregullatorit për të rregulluar/përshtatur normat në funksion të zgjedhjeve të lira e të pandikuara. Në këto pozita, ne dy anëtarët e Komisionit Rregullator ndërmarrim nismën për propozimin e disa shtesave e ndryshimeve në Vendimin nr. 9/2020, me qëllim garantimin e një procesi zgjedhor të lirë e të ndershëm. Gjithashtu, e përmendi dhe kolegja Vukaj, faktin që në datën 21 dhjetor, në mbledhjen e Komisionit Rregullator, për disa shtesa e ndryshime që kemi zhvilluar këtu në këtë sallë është propozuar shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 9, kemi rënë dakord, kemi diskutuar me drejtoreshën përkatëse dhe na është pohuar fakti që është duke u punuar. Dakord, ka qenë një nevojë ndryshimi i

*Zbardhi materialin audio  
Areta DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt. 30.01.2025*

vendimit nr. 9, për faktin do të duhej të implementohej platforma e raportimit. Me dëshirën e mirë, me qëllim konstruktiv ne të pestë kemi rënë dakord dhe e kemi miratuar. Në këndvështrimin tonë do të duhej që të gjitha ato propozime apo ndryshime të propozuara në aktin e Komisionerit që na ka sjellë për njohje, do të duhej të paraqiteshin përpara datës 11 janar, kur fillon periudha 4 mujore, e parashikuar në Kodin Zgjedhor. Pikërisht se ishim në periudhën pas datës 14, dhe në mbledhjen e datës 15 janar, këtu kemi bërë përsëri pyetjen.., mund ta.., është e regjistruar mbledhja, mos gaboj 1 orë e 20 minuta e më pas, ku kolegia Vukaj ju ka drejtuar pyetjen “Keni menduar mundësinë e shqyrtimit për ndryshime në Vendimin nr. 9?”. “Sot në mbledhje nuk kemi asnjë propozim”, keni deklaruar. Dakord! Në këto kushte ne dy anëtarët e Komisionit Rregullator, duke vlerësuar se ndodheshim në kushtet e nenit 12, pika 4 të Kodit Zgjedhor, ku parashikohet “nëse ka çështje të rendit të ditës, ose çështje të natyrës rregullatore, të cilat nuk propozohen nga Komisioneri, atëherë vetë secili anëtar, ose në rastin konkret dy mund të kërkonë vetëmbledhjen e Komisionit Rregullator me këto propozime konkrete”. Në vlerësimin tonë, ndërhyrja dhe marrja e masave për përshtatjen e përmbajtjes së vendimit nr. 9 është e domosdoshme dhe e pashmangshme. Për të mos u zgjatur më tej, ndryshimet tona vetëm po i citoj, mos t'i lejoj, sepse ju jeni njohur, të gjitha palët janë njohur me propozimin tonë. Kisha dhe një, përpara se të kaloj vetëm në citimin e propozimit, kisha edhe diçka të vogël me KRIIK-un. Ne i pamë ato ndryshime tuaja, po jemi njohur vetëm sot. Përpara ditës sotme ju keni dërguar një email, ku në gjykimin dhe vlerësimin tuaj të drejtë, kishit kërkuar bashkimin e projektaktit tonë me projektaktin e Komisionerit. Jo, dakord, por vetëm një merak, se problemi qëndron këtu që ju në gjykimin tuaj nuk e paragjykoi, mund të duhej pak më shumë kohë për të ashtu.., për zgjedhjet e 2027 e kërkon? Sepse ka filluar. Duke e mirëkuptuar dhe vlerësuar me objektivitet gjithë bashkëpunimin që kemi pasur, ne

*Zbardhi materialin audio  
Areta DULAKU*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt. 30.01.2025*

mendojmë se jemi tashmë shumë të vonuar. Megjithatë do keni dhe kohë më pas. Propozimet tona konsistojnë: Në nenin 1, pikë 1 “Parime të përgjithshme”. Kemi pikat 1, 2, 3, 4 dhe 5 të riformulohen siç kemi propozuar, duke përfshirë konceptin e procesit të raportimit të gjithë veprimtarive me karakter publik brenda dhe jashtë vendit. Pra, raportimi nga ana e institucioneve do të duhet të realizohet dhe për veprimtaritë publike që zhvillohen brenda dhe për ato jashtë vendit. Sot nuk është e rregulluar. Në nenin 2, kemi propozuar riformulimin e konceptit të veprimtarive publike. Në nenin 3, në pikën 1.1 të shtohet titulli “Veprimtari të ndaluar për të promovuar brenda dhe jashtë vendit”. Në nenin 3, “Veprimtari të ndaluara”, kemi propozuar riformulimin e pikës 1.1, po kështu në nenin 3 në pikën 1.3 të shtohet titulli “Veprimtari e ndaluar” dhe kemi propozuar edhe riformulimin e përkufizimit të konceptit “veprimtari e ndaluar”. Pas përkufizimit të mësipërm, fjalia e parë, pika 1.3, fjalia e parë ekzistuese të riformulohet, “veprimtaria e ndaluar përfshin...”, por pa u kufizuar. Këtu është ai momenti. Në shkronjën “c”, të pikës 1.3, të nenit 3, kemi propozuar riformulimin e asaj problematike që ka konstatuar kolegët tanë të KAS-it, duke parashikuar periudhën katërmujore. Më tej akoma neni 6 “Të drejtat dhe detyrimet e punonjësit të administratës shtetërore”, pika 5 kemi propozuar riformulimin. Pra, çfarë duhet të ketë konsideratë punonjësi administratës shtetërore gjatë pjesëmarrjes në një veprimtari politike, apo zgjedhore. Më tej akoma, nenin 6 “Të drejtat dhe detyrimet e punonjësit administratë shtetërore”, pas pikës 7, kemi propozuar të shtohen pikat 8, 9, 10 dhe 11, e cila normon veprimtarinë e punonjësve të Policisë së Shtetit, punonjësve të Gardës së Republikës së Shqipërisë, punonjësve të Shërbimit Informativ dhe punonjësve të ushtarakut aktiv.

**Znj. H. Vukaj:** Një ndërhyrje e vogël ju lutem, një referencë për shumicën e pikave është marrë vendimi 473 i datës 01.06.2017. Ky është një vendim i Këshillit të

*Zbardhi materialin audio  
Areta DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt. 30.01.2025*

Ministrave, i miratuar me qëllim çeljen e siparit për rregullimin e kësaj situate dhe për balancimin apo peshimin e drejtë të administratës në momentin kur procesi zgjedhor e kërkon me domosdoshmëri që palët të garojnë në mënyrë të barabartë. VKM-ja quhet “Për marrjen e masave dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes apo përdorimit burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore gjatë procesit zgjedhor, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë për vitin 2017”. Pra, ky është një vendim i Këshillit të Ministrave, absolutisht që ka dhënë rezultat në vitin zgjedhor që është aplikuar dhe është përshëndetur madje edhe nga organizatat monitoruese në atë periudhë. Kemi marrë disa koncepte, të cilat mendojmë që përshtaten dhe e plotësojnë vendimin nr. 9. Kështu që ky është një referencë e cila i ka dhënë frytet dhe është e testuar, e provuar dhe madje është miratuar me konsensusin e të gjitha palëve. Pavarësisht se formën e ka Vendimi Këshilli i Ministrave, ju e dini konsensusin e vitit politik të vitit 2017.

**Znj. I. Nano:** Faleminderit! Keni me për të relatuar?

**Z. M. Çakaj:** Po! në përfundim të gjithë sa më sipër kërkojmë, nga Komisioni Rregullator, sigurisht jemi të hapur për çfarëdolloj diskutimi që kolegët mund të kenë dhe kërkojmë nga Komisioni Rregullator miratimin e këtij projektakti. Faleminderit!

**Znj. I. Nano:** Faleminderit, zonja Vukaj, zoti Çakaj. Zoti Nuri, diskutim në parim?

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Partisë Demokratike:** Në parim, po!

*Zbardhi materialin audio  
Areta DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt. 30.01.2025*

**Znj. I. Nano:** Po! Ta çel diskutimin në parim, se mendova mos të kishim ndonjë pyetje. Në fakt Ju e kërkuat fjalën, po ua jap dhe pastaj dhe nëse kanë dhë anëtarët e Komisionit Rregullator.

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Partisë Demokratike:** Faleminderit, zonja Nano! Atëherë, patjetër që e gjej me vend propozimin e dy anëtarëve të Komisionit Rregullator dhe në parim e mbështesim si Parti Demokratike për arsye që e relatuam edhe në fillim të kësaj seance. Për shkak se ne vlerësojmë se ka një boshllëk në këtë kuadër rregullator dhe do të duhet që ai të plotësohet dhe përmirësohet dhe madje do të ishte bërë përpara datës 11 janar. Megjithatë, duke nisur dhe nga diskutimi i zotit Çakaj dhe nga relatimi i tij lidhur me vështirësitë për regjistrimin në platformën elektronike në PER të diasporës në KQZ, kemi dhe një rast të fundit, që sapo është denoncuar publikisht nga një deputet i Partisë Demokratike, përpara pak minutash. Deputeti Edmond Spaho në rrjetet e tij sociale ka publikuar një rast që duhet verifikuar patjetër dhe me shpejtësi nga organet ligjzbatuese. Bëhet fjalë për një rast në Greqi, ku sipas deputetit Spaho, disa të njohur të tij të Bashkisë Maliq, emigrantë në Greqi me banim në Athinë, i kanë shkruar se i kanë shkuar në shtëpi një vajzë nga KQZ, e cila ju ofroi t'i regjistrojë për zgjedhjet e 11 majit. Duke mirbesuar ata qytetarë i kanë dhënë dokumentet, lihet të kuptohet për t'u regjistruar. Më pas deputeti i habitur nga kjo situatë ka bërë verifikimet përkatëse dhe patjetër që rezulton që KQZ-ja nuk kryen regjistrime, as në terren dhe as jashtë vendit dhe aq më pak në banesat e qytetarëve.

*Zbardhi materialin audio  
Areta DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 30.01.2025*

**Z. F. Nuri, përfaqësues i PD:** Ndaj ne kërkojmë që të bëhet transparenca maksimale për këto raste. Kërkojmë që Partia Socialiste të heqë dorë nga patronazhimi i diasporës, të distancohet nga këto ngjarje. Administrata shtetërore apo kushdo qoftë nuk mund të shkojë dhe të regjistrojë qytetarët, aq më tepër t'u shkojë në banesa jashtë vendit, kudo qofshin ata. Pra kërkojmë që të ketë një distancim në lidhje me këto praktika, që vlerësojmë janë të jashtëligjshme dhe të cilat tentohet të deformohet vullneti i votuesve, i emigrantëve shqiptarë dhe kërkojmë që KQZ-ja të shprehet publikisht për rastin, ta hetojë rastin e denoncuar publikisht nga deputeti Spaho. Faleminderit!

**Znj. I. Nano:** Faleminderit z. Nuri! Në parim për aktin nuk kishit gjë?

**Z. F. Nuri, përfaqësues i PD:** U shprehëm që në parim ishim plotësisht dakord me propozimin.

**Znj. I. Nano:** Dakord, mund të ishte shqyrtim jashtë rendit të ditës dhe unë do t'ju jepja fjalën gjithsesi, e konsumuat dhe në këtë moment procedural.

**Z. F. Nuri, përfaqësues i PD:** Faleminderit!

**Znj. I. Nano:** Atëherë e kemi çelur diskutimin në parim, përfaqësues të partive politike kanë folur. Po z. Çaka.

**Z. D. Çaka:** Faleminderit znj. Kryetare! Do të doja të shprehja vlerësimin tim në parim për aktin, por përpara, duke pasur parasysh të gjitha komunikimet që kemi konsumuar me Komisionin, me administratën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve,

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 30.01.2025*

ato midis nesh, me përfaqësues, me disa përfaqësues të shoqërisë civile. Do të doja t'i bëja një pyetje përfaqësues, Drejtoreshës Juridike, akti i cili është sjellë për njohje nga ana e Komisionerit, i qëndroni për t'u risjellë në formatin e një akti të propozuar zyrtarisht?

**Znj. P. Doçaj:** Po faleminderit! Ju kemi përcjellë një akt për njohje dhe për mendim, pra projektvendim "Për rregullat e sjelljes së institucioneve publike në zgjedhje dhe ndalimin e keqpërdorimit të aseteve publike", i qëndrojmë këtij akti dhe do ta propozojmë në formë zyrtare duke respektuar Kodin Zgjedhor.

**Z. D. Çaka:** Pyetja ime...

**Znj. P. Doçaj:** Pra, ndryshimet që ky projektvendim do të synonte janë ndryshime shteruese, pra që i bëjnë vendimit nr. 9, ashtu sikundër është kërkuar nga ana juaj që të plotëhet vendimi nr. 9 dhe në datën 15 janar, ku nga ana ime është pohuar që jemi duke punuar për këtë akt, në përfundim të punës së kryer për këtë akt është dërguar për njohjen tuaj dhe do të propozohet zyrtarisht për t'u shqyrtuar.

**Z. D. Çaka:** Atëherë pyetja, për të pasur një sqarim brenda vetes sime në atë çfarë dhe unë më pas do të relatoj, dua të theksoj që jemi në një moment në të cilin besoj të gjithë jemi të gatshëm, të paktën ne të pestë që jemi si Komision Rregullator, por besoj dhe administrata dhe shoqëria civile, e cila i ndjek me ritmin e vazhdueshëm punën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, partitë politike që aktet mund të kenë nevojë për ndryshime. Jemi të gjithë të gatshëm të bëjmë ato ndryshime të cilat sjellin përmirësime të këtyre apo përmirësimeve të procedurave të caktuara, pra që janë gjithmonë bëjmë fjalë për kompetencën tonë si Komision Rregullator. Kështu

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 30.01.2025*

që çdo ndryshim, çdo propozim unë e vlerësoj se ka atë rëndësinë e tij, pavarësisht nëse pranohet apo jo dhe dua t'i falenderoj dhe kolegët për iniciativën dhe ka pasur raste të tjera që ne kemi marrë iniciativa si Komision Rregullator dhe mundet ta bëjmë dhe më shpesh, kur ne mendojmë që ka nevojë për ndryshime të akteve. Pastaj është në vlerësimin e secilit prej nesh është mënyra sesi votohet për secilin prej këtyre propozimeve. Në lidhje me këtë situatë shoh që keni disa drafte të cilat po themi janë propozuar zyrtarisht, janë sjellë për mendim, janë sjellë sugjerime, pra kemi rreth katër drafte të cilat vinë, në radhë të parë atë që po shqyrtojmë nga kolegët tanë. Një draft i cili jo në mënyrë zyrtare është sjellë nga Komisioneri, drafte të propozuara nga shoqëria civile, nga KRIIK, pra për sa u përket ndryshimeve nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, të cilat në thelb kërkojnë një ndryshim jo të vogël të aktit, të cilin ne jemi duke shqyrtuar sot. Jemi në mes të periudhës, i përfshin pikërisht objektin e këtij vendimi, kështu që vlerësoj që çdo ndryshim që mund t'i bëhet nëse vlerësohet nga ne, duhet të kemi parasysh që mund të ndikojë edhe në punën e institucioneve publike çdo ditë. Kështu që në këtë moment unë personalisht dakordësoj për një sugjerim të bërë nga shoqata KRIIK, të cilën e vlerësoj dhe përgëzoj gjithmonë për propozime, për përmirësime të akteve, të cilin mendoj që akti të ketë një ndryshim të paktën të unifikuar. Ne sot mund ta votojmë sipas vlerësimit të secilit prej nesh dhe mund t'i bëjmë këto ndryshime të propozuara nga kolegët, mirë po mund të na ndodhë që të hënën të mblihdemi prapë për të shqyrtuar propozime të tjera nga Komisioneri apo dhe propozime të sjella nga organizata. Duhet të kuptojmë një gjë, që patjetër që roli jonë të rregullojmë aktet, por duhet të edhe të mos krijojmë një konfondim, punën e institucioneve shtetërore. Unë personalisht mendoj që nëse këto akte brenda një periudhe një javore mund të ndryshojnë dy herë, tre herë, të sjellë këtë problematikë. Kështu që vazhdoj i qëndroj propozimit të bërë nga KRIIK-u dhe mendoj që do të ishte më mirë që të kemi

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 30.01.2025*

unifikim të aktit të sjellë për ndryshim dhe me propozime të saj të ndryshme dhe nga kolegët, nga të gjitha palët. Çfarë do të thotë kjo? Nëpërmjet kësaj, për të mos krijuar këtë konfondim unë desha të jepja një arsye time përse do ta votoj në parim kundra këtë ndryshim të sjellë nga kolegët, për të pasur një mundësi të gjithë së bashku nëse duam të ndryshojmë për përmirësim, duke qenë se jemi në këtë moment kritik dhe fazë të rëndësishme të këtij procesi, jemi duke zhvilluar, ky proces të mos krijojmë dhe më shumë konfondime nëse ka jashtë në institucione shtetërore. Faleminderit!

**Znj. I. Nano:** Faleminderit z. Çaka! Zonja Vukaj. Po diskutimi në parim thamë.

**Znj. H. Vukaj:** Në parim patjetër. E dëgjova kolegun dhe normalisht që mirëkuptoj qasjen e tij për të mos votuar edhe kundra sepse normalisht prevalon ndoshta propozimet e një Komisioneri, para dy anëtarëve të Komisionit Rregullator dhe kjo u pa në tentativat e bëra, por i nderuar koleg këto janë ekzigjente, këto ndryshime të propozuara dhe nuk mund të presin as kur Komisioneri t'i mbyshet mendja ta bëjë zyrtare atë propozimin që mund të jetë mbas disa ditëve, pas disa javëve e kështu me radhë ose mund të ndodhemi në të papriturën që mund të heqë dorë, tërheq aktet, mund të thoni dhe ju që s'e kemi në kompetencë propozimet e tij etj., etj. Pra, në kuadër të thirrjes së madhe për domosdoshmërinë e këtyre ndryshimeve, unë ju ftoj ta rishikoni qëndrimin tuaj kolegë sepse këto ndryshime duhen bërë menjëherë dhe mendoj dhe vlerësojmë se këto ndryshime të propozuara mbyllin ato boshllëqet, të cilat i vënë fre partisë politike që ka favore dhe valenca apo supervalenca në këtë rast për të ndikuar procesin zgjedhor. Kështu që rishikojeni në të mirë të procesit dhe në konstruktivitet të procesit këtë ndërhyrje që po i bëjmë këtij akti për ta votuar sot dhe për t'i shtrirë efektet menjëherë sipas përcaktimeve të Kodit Zgjedhor. Mendojeni dhe njëherë ju lutem sepse po i bëjmë një dëm procesit me këto zvarritje

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 30.01.2025*

apo me këto justifikime, jo bashkime aktesh, jo unifikime. Ku e dini ju nëse ne i kemi marrë apo s'i kemi marrë në konsideratë Komitetin Shqiptar të Helsinkit apo organizatën e KRIIK, pra ne edhe mund t'i kemi unifikuar në propozimin tonë vijues, kështu që s'kemi arsye për të paragjykuar që këto nuk janë marrë në konsideratë. Rishikojeni ju lutem sepse do t'i shërbeni të gjithë shqiptarve për të pasur armë të barabarta në garim, ata që do të jenë garues dhe partive politike në të njëjtën kohë. Faleminderit!

**Znj. I. Nano:** Faleminderit zonja Vukaj! Zoti Çaka.

**Z. D. Çaka:** Patjetër jam shumë dakord me ju që mundet mos ta sjellë Komisioneri aktin. Ajo çfarë unë thashë nuk lidhet fare me propozimin që mund të bëjë Komisioneri sepse ne nuk jemi të ndërlidhur me një propozim të Komisionerit. Fakti që kemi disa drafte edhe nëse e sjell apo nuk e sjell Komisioneri ne nuk na ndalon, ne të pestëve apo secilin prej nesh që mundet ta bëjë këtë unifikim të aktit dhe ta sjellë si propozim. Pra, thelbi i asaj që unë thashë nuk ka lidhje me faktin se kush e sjell draftin, po për faktin që këto drafte të jenë të unifikuara në një të tillë për t'u shqyrtuar, për shkak të asaj problematike që unë sqarova dhe nuk na ndalon askush që edhe nëse nuk e sjell Komisioneri këtë propozim ta kemi ne, t'i marrim këto akte dhe mundet edhe t'i unifikojmë dhe t'i propozojmë secili nga ne. Ndërsa në lidhje me faktin tjetër, e lidha thjesht me kohën në të cilën kanë ardhur propozimet nga shoqëria civile, pra janë të mëvonshme në lidhje me propozimin që ju keni bërë dhe thjesht është efekti kohë ai që e përcakton këtë, pra kjo ishte, pra nuk lidhet fare me e sjell, nuk e sjell Komisioneri. Në mendimin tim mund të mos jetë, mund të kemi një zgjidhje tjetër, pra atë që ju thashë, mund ta bëjmë ne dhe nëse nuk e sjell, mund t'i bashkojmë, mund t'i shqyrtojmë.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 30.01.2025*

**Znj. H. Vukaj:** Pikërisht pra ne njoftim zyrtar, pra zyrtar, rend dite për mbledhjen e sotme kemi propozimin e dy anëtarëve të Komisionit Rregullator, çka do të thotë që zyrtarisht janë këto. Në momentin kur Komisioneri të propozojë zyrtarisht ndoshta në prill, ndoshta në maj hajde të ulemi dhe të shikojmë se për çfarë nevojë kërkon Komisioneri të na mbledhë. Përfaqësuesin e KRIIK e kemi këtu dhe të krijojmë ekonomikitet kohe, të paktën për nevojën që ka ky akt për t'u ndryshuar në mënyrë imediate. E kemi këtu përfaqësuesin e KRIIK, Komiteti Shqiptar i Helsinkit na e ka dërguar me shkrim dhe janë propozime që i implementojmë menjëherë, mjafton të kemi bonsensin dhe ndaj dhe njëherë ju bëj thirrje që ta pranoni parimisht në fund në tërësi të gjithë propozimet tona. Faleminderit!

**Znj. I. Nano:** Faleminderit zonja Vukaj! Atëherë lidhur me, në kuadër të diskutimit në parim, sikundër dhe ju z. Çakaj diskutuat, keni propozimin tuaj zyrtarisht po e diskutojmë sot. Kemi një propozim të Komisionerit, kemi një projektakt të ardhur për mendim. Nuk është kështu? Unë nuk di si ta quaj ndryshe. Është projektakt...


**Znj. H. Vukaj:** Ne mund të na vinë shumë drafte për mendim...

**Znj. I. Nano:** Zonja Vukaj tani folët për ekonomi të kohës, po ta bëjmë si ndeshje, kush e kishte topin më shumë apo më pak. Unë sapo mora fjalën

**Znj. H. Vukaj:** Kam shumë të drejtë që të ndërhyj. Po gjeni mekanizma, artificia...

**Znj. I. Nano:** Jo nuk ke të drejtën të më ndërpresësh, jam duke folur në parim për projektaktin, si...

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 30.01.2025*

**Znj. H. Vukaj:** Po ne na ka ndërprerë administrata ju s'keni ndërhyrë...

**Znj. I. Nano:** ...të lutem, si një nga pesë anëtarët...

**Znj. H. Vukaj:**...administrata kanë marrë supervalencë!

**Znj. I. Nano:**...vazhdo kur të mbarosh më thuaj!

**Znj. H. Vukaj:** Në qoftë se ju nuk respektoni rregulloren kur administrata ndërhyt...

**Znj. I. Nano:** Unë mora fjalën të flas në parim si një nga pesë anëtarët, sapo thashë po flas në parim.

**Znj. H. Vukaj:** Po gjeni artificia zonjë, për ta hedhur poshtë aktin.

**Znj. I. Nano:** Të lutem, unë nuk i hyj në meritë as aktit, as relacionit, as gjithçkaje që thatë, fare. Nuk po i hyj, jam duke diskutuar në parim për projektvendimin që kemi në shqyrtim, të propozuar nga dy anëtarët, mund të kisha thënë shumë pak, jam dakord, s'jam dakord në parim dhe të kalojmë në votim. Jam duke folur...Hajde më mirë ashtu pra, ju folët një orë, unë nuk duhet të flas tre minuta!

**Znj. H. Vukaj:** Jam propozuesja.

**Znj. I. Nano:** Le të jesh propozuesja, mbarove relacionin? Tani është diskutimi në parim, në parim jemi të gjithë për të folur, përfaqësuesit e partive politike, po ia jap

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 30.01.2025*

unë fjalën vetes, nuk ma jepni ju: “Urdhëro, fol”! Pra, po thoja kemi në email-let tona të ardhura, dy mendime nga organizata KRIIK, pra dy email-e dhe një nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit. Në email-in e parë nga organizata KRIIK, z. Çaka iu referua, ku diskutohej ideja e bashkimit të këtyre projektvendimeve në një të vetëm, pa vënë në asnjë moment, asnjëri prej nesh në dyshim rëndësinë e projekteve që kanë ardhur për diskutim dhe nevojën për të bërë ndryshime, në asnjë moment nuk është vënë në dyshim kjo gjë. Në email-in e dytë kanë ardhur mendimet e organizatës KRIIK, në email-et dhe mendimet e Komitetit Shqiptar të Helsinkit kanë ardhur mendime, jo për projektaktin që keni propozuar ju. I kemi të gjithë të printuar: “Mendim për projektvendimin “Për rregullat e sjelljes së institucioneve publike në zgjedhje dhe ndalimin e keqpërdorimit të aseteve publike”. Pra është kthyer në përgjigje të email-it lidhur me mendimin që kërkohet për projektvendimin e Komisionerit. Kështu që edhe unë po e theksoj njëherë, pa i hyrë në meritë gjithçkaje që keni propozuar. Do të vlerësoja që në një moment, që pasi ta mbyllim këtë mbledhje, me cilindo rezultat që do të jetë kjo mbledhje, të ulemi të gjithë së bashku të marrim të gjitha mendimet, të organizatave. Të mos harrojmë na kanë ardhur mendime nga organizata të tjera, KRIIK-u nuk është herë e parë që dërgon mendim për vendimin 9, NDI ka dërguar mendime për vendimin 9, organizata të tjera kanë dërguar mendime dhe propozime për ndryshimin e vendimit 9. Atëherë jemi në kohën, meqenëse e kemi zyrtarisht tashmë të çelur këtë diskutimi, për ndryshimin e vendimit 9, le të ulemi të gjithë së bashku sot, nesër, pasnesër, ta mbyllim këtë, të sjellim një draft të konsoliduar, ku të përfshihen të gjitha rregullimet mundshme, që plotësojnë vendimin 9 apo një rishikim tërësor të vendimit 9. Ky është qëndrimi im në parim lidhur me këtë çështje. Diskutime të tjera në parim? Po zoti Çakaj.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 30.01.2025*

**Z. M. Çakaj:** Unë jam 100% dakord me konstatimin tuaj dhe sigurisht edhe me konstatimin e kolegut Çaka. Në këtë kontekst, duke parë qëndrimin tuaj, unë ju ftoj që së bashku të gjithë ta miratojmë në parim dhe gjithë ato ndryshime çfarë ka propozuar qoftë Komisioneri, në aktin që na ka sjellë për njohje, po s'ka ardhur zyrtarisht, qoftë propozimet e organizatës KRIIK apo organizatave të tjera, të cilat nuk e dimë nëse janë njohur me dratin tonë apo jo? Se më duket pak e çuditshme të japin komente dhe shtesa dhe vlerësime për një projektakt dhe për tjetrin jo, kjo është pa e dyshimtë, megjithatë pak rëndësi ka. Bie shumë dakord me vlerësimin tuaj në parim të gjithë kësaj shtese. Atëherë ne të gjithë siç jemi këtu të pestë, e miratojmë aktin në parim dhe sigurisht nëse ka nevojë për diskutime nen për nen, e ndërpresim mbledhjen këtu, ulemi në ditët në vijim, i japim kohë vetes por të gjithë aktorëve dhe faktorëve të interesuar në këtë proces dhe çfarë arrijmë dakordësi, një, dy, disa shtesa e ndryshime prodhojmë një akt, i cili do t'i shërbejë procesit. Kështu që bie dakord, nëse ju e vlerësoni, nëse keni nevojë për kohë patjetër, por nëse ju e gjykoni që gjeni një hapësirë atëherë pse mos ta miratojmë në parim dhe kur të vijë momenti i diskutimit në çdo nen, jam dakord me ju të ulemi ta diskutojmë paraprakisht. Merrni kohën tuaj, vlerësojeni dhe sigurisht ky propozimi im vlen.

**Znj. I. Nano:** Diskutime të tjera në parim ka? Kalojmë në votimin në parim. Kush është dakord në parim me propozimin e dy kolegëve për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.9, datë 24.12. 2020, të ndryshuar të Komisionit Rregullator? S'po e lexoj titullin se është i gjatë. Kush është dakord kolegë?

**Kush është dakord?**

**Pro:** 2 (znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

**Kundër:** 3 (znj. I. Nano, z. D. Çaka, z. A. Çela)

**Nuk miratohet!**

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 30.01.2025*

Atëherë për shkak se akti nuk mori votat e nevojshme në parim nuk mund të kalojë në nen për nen. Përpara se ta mbyll mbledhjen meqenëse nuk ka çështje jashtë rendit të ditës, përsëris dhe njëherë ftesën për të parë mundësinë e rishikimit tërësor të vendimit 9, jo thjesht për të bërë disa shtesa dhe ndryshime, por një vendim të ri për të zëvendësuar vendimin 9. Mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

**Vendimi nr. 5**

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*

